



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
DREJTORI EKZEKUTIV

Nr. prot. 1635

Tiranë 04/09 /2019

VENDIM

Nr. 10 Datë 04.09 2019

“Për pranimin e AMC, GM dhe CS, për zbatimin e Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 122, datë 12.03.2019”

Në mbështetje të nenit 13, gërma “g” të Ligjit Nr. 10 233, datë 11/02/2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, i ndryshuar dhe Nenit 6, pika 2 (a), Shtojcës 2 ADR.KA.A.015, ADR.KA.C.020; ADR.KO.B.050 të Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 122, datë 12.03.2019 “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave administrative që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSA:

1. Pranimin e Mjeteve të Pranueshme të Pajtueshmërisë (Acceptable Means of Compliance), Materialet Udhëzuese (Guidance Material) dhe Specifikimet e Certifikimit (Certification Specifications) të rekomanduara nga EASA, për zbatimin e Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 122, datë 12.03.2019 që transponon rregulloren EU 139/2014.
2. Këto materiale do të përdoren në gjuhën angleze sipas variantit të konsoliduar të publikuar nga EASA, deri në përkthimin e tyre në gjuhën shqipe.
3. Ngarkohet Drejtoria e Mbikqyrjes së Aeroporteve për ndjekjen dhe zbatimin e kërkesave të mësipërme të rekomanduara nga EASA dhe pranuar nga AAC.
4. DMA të marrë masa të informojë aplikantët apo operatorët ekzistues për aksesimin e varianteve të përditësuara të AMC, GM, CS të pranuar sipas këtij vendimi, sic janë publikuar në faqen e EASA-s.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Krislen Keri

